

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 1-2021

“INTERVISTA E SUKSESSHME NË MEDIAT E SHKRUARA NË KOSOVË DHE AFTËSIA E INTERVISTUESIT”

Kujtesë Berisha

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Communication Commons](#)

Recommended Citation

Berisha, Kujtesë, “INTERVISTA E SUKSESSHME NË MEDIAT E SHKRUARA NË KOSOVË DHE AFTËSIA E INTERVISTUESIT” (2021). *Theses and Dissertations*. 2097.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2097>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT

Fakulteti për Media dhe Komunikim

**“INTERVISTA E SUKSESSHME NË MEDIAT E SHKRUARA NË
KOSOVË DHE AFTËSIA E INTERVISTUESIT”**

Shkalla Bachelor

Kujtesë Berisha

Janar, 2021

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Media dhe Komunikim

Punim Diplome
Viti akademik 2017/2018

Kujtesë Berisha

**“Intervista e suksesshme në mediat e shkruara në Kosovë dhe aftësia e
intervistuesit”**

Mentori: Msc.Musa Sabedini

Janar, 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Në këtë punim do të ofrojë vlerësime profesionale se çfarë është intervista.

Gjatë kësaj teme të diplomës do të kuptoni më shumë rreth historisë së gazetave në Kosovë.

Cilat ishin gazetat e para në Kosovë, sa lexoheshin ato dhe sa lexohen sot.

Të gjitha këto duke u bazuar në shtypin periodik shqiptar gjatë viteve 2000-2005.

Në veçanti do të shfletohen arkivat e gazetave “Koha Ditore”, “Epoka e re”, “Zëri. Të cilat cilësohen si gazetat më të lexuara në Kosovë.

Do të ketë një krahasim të vogël mes gazetave dikur dhe gazetave të ditëve të sotme.

Gjithashtu do të intervistohen gazetarët e mediave të shkruara që janë marrë gjatë me publikimin e gazetave si: Halil Matoshin, Përparim Isufin, Agron Bajramin, Haqif Mulliqi.

Gjatë intervistave me gazetarët në fjalë i’u është bërë pyetja se cila mendoni që është intervista e juaj më e suksesshme që keni realizuar deri më sot, pra do të njoftoheni prej më afër me intervistat që kanë bërë jehonë rreth një ngjarje të caktuar në Kosovë.

Në agjendën e këtij punimi do të ketë edhe një anketë me qytetarët për mediat e shkruara, duke marrë mendimet e tyre rreth gazetave dhe se çfarë pëlqejnë më shumë në gazeta.

Ku nga kjo anketë do të kuptojmë rëndësinë e mediave të shkruara(gazetave).

Fjalë kyçe: *Intervista, gazetat, shtypi, publiku*

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Dua të falënderoj familjen time ku falë tyre jam këtu ku jam sot, faleminderit për sakrificën dhe mundin duke mos kursyer asgjë për mua. Çdo fjalë është e vogël në krahasim me kontributin e tyre për mua, duke mos më munguar asgjë gjatë këtyre viteve të studimit.

Dua të shprehë konsideratë për institucionin ku unë studiova, i cili më dha vetëm dije dhe njëkohësisht më shtoi edhe më shumë dashurinë për profesionin tim.

Pa dyshim që një falënderim i thellë shkon për profesorin Musa Sabedini, që e mentoroi temën time të diplomës. Punimi i një teme diplome të nivelit bachelor nuk do të më dukej kaq i lehtë nëse do të më mungonte përkrahja e vazhdueshme profesionale dhe morale e mentorit tim.

Faleminderit të gjithëve që qëndruan pranë meje gjatë këtij rrugëtimi.

Ju falënderoj përjetësisht!

Tabela e Përmbajtjes

<u>1 Hyrje</u>	1
<u>2 SHQYRTIMI I LITERATURËS</u>	2
<u>2.1. Intervista</u>	3
<u>2.2 Avantazhet dhe dizavantazhet e intervistave</u>	11
<u>2.3. Shtypi periodik në Kosovë gjatë viteve 2000-2005</u>	12
<u>2.4. Arkivi nga gazeta Koha Ditore</u>	15
<u>2.5. Arkivi nga gazeta Epoka e re</u>	17
<u>2.6. Arkivi nga gazeta Zëri</u>	18
<u>3. DEKLARIMI I PROBLEMIT</u>	20
<u>3.1. Mediat e shkruara dikur dhe sot</u>	20
<u>4. METODOLOGJIA</u>	26
<u>5. Prezantimi dhe analiza e rezultateve</u>	27
<u>5.1. Intervista me gazetarin/analistin Halil Matoshi</u>	27
<u>5.2. Intervista me gazetarin Përparim Isufi</u>	29
<u>5.3. Intervista me gazetarin Agron Bajrami</u>	32
<u>5.4. Intervista me gazetarin Haqif Mulliqi</u>	35
<u>6. KONKLuzionet dhe Rekomandimet</u>	41
<u>6.1.Rekomandime</u>	41
<u>7.REFERENCAT</u>	42

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

Lista e figurave:

<u>Figura 1. Logoja e UBT-s</u>	
<u>Figura 2. Logoja e gazetës Koha Ditore</u>	14
<u>Figura 3. Logoja e gazetës Epoka e re</u>	16
<u>Figura 4. Logoja e gazetës Zëri</u>	18
<u>Figura 5. Foto e gazetave të mëparshme</u>	24
<u>Figura 6. Foto e gazetave sot</u>	25
<u>Figura 7. Foto e Halil Matoshit</u>	27
<u>Figura 8. Foto e Përparim Isufit</u>	29
<u>Figura 9. Foto e Agron Bajramit</u>	32
<u>Figura 10. Foto e Haqif Mulliqit</u>	35

LISTA E TABELAVE

Anketa e përgatitur me qytetarët do të prezantohet në formë të tabelës në fund të punimit, më saktësisht tek prezantimi i rezultateve.

1. HYRJE

Dihet që gazetat luajnë një rol mjaftë të madh në fushën e gazetarisë. Njerëzit qysh në fillim të publikimit të tyre kanë krijuar një lloj simpatie për to, kjo simpati vazhdon akoma edhe në ditët e sotme.

Për dallim nga mediat e tjera lajmet në gazeta mund t'i ruajmë me vite të tëra. Kohëve të fundit duket sikur gazetat në gjithë botën nuk lexohen më, arsye kjo sepse teknologjia ka avancuar me të madhe, dhe janë krijuar shumë televizione, portale, ose siç njihen edhe si media online, dhe njerëzit ose publiku nuk mund të pret deri ditën e nesërme për të parë të rejtat që ndodhin në vend, rajon dhe botë.

Intervista në gazeta është akoma e veçantë, simpatizuesit e vërtetë të gazetave e lexojnë njëllor si herën e parë. Intervista në gazeta është e zhanrit të gjatë, ku është e ilustruar edhe me fotografi dhe një biografi të shkurtë të personazhit që do të intervistohet.

Gazetat njihen edhe për faktin që lajmet nga gazetat janë më të besueshme, kur nuk kishte internet dhe njerëzit prisnin me padurim gazetat për t'i lexuar, atë kohë u formua edhe opinionit publik.

Ka ndodhur shumë shpesh të dëgjojmë teksa thonë se gazetat luajnë një rol mjaftë të madh tek krijimi i opinionit publik në çështjet e caktuara, sidomos nga intervistat.

Tek ky punim diplome do të gjeni intervistat të cilat bënë jehonë të madhe në Kosovë, të cilat gazetarët përkatës i cilësojnë edhe si intervistat e tyre më të suksesshme gjatë karrierës si gazetarë të mediave të shkruara.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Intervista

Për të arritur tek tema e këtij punimi e cila është “Intervista e suksesshme në mediat e shkruara në Kosovë dhe aftësia e intervistuesit”, ne duhet t’u rikujtojmë se çka është intervista dhe çfarë është intervista e suksesshme.

Intervista është zhanër shumë i popullarizuar gazetaresk. Rrjedh nga anglishtja dhe do të thotë takim ose bisedë. Intervista bëhet me një person të njohur rreth një teme aktuale. Gazetari nuk pyet kot, por kërkon përgjigje relevante. Shpesh konsiderohet si një lajm i shprehur në formë dialogu.

Se sa një intervistë do të jetë e suksesshme varet nga aftësia e intervistuesit, por edhe bashkëbiseduesit.

Që intervista të jetë e suksesshme duhet që të zgjidhet tema, bashkëbiseduesi dhe pyetjet e parashtruara. Të bësh pyetje është po aq vështirë sa të përgjigjesh. Gazetari nuk do të dështojë nëse ka njohuri paraprake rreth temës për të cilën do ta pyes bashkëbiseduesin.

Gazetari konsulton burime të ndryshme. Lexon sa më shumë për temën dhe për bashkëbiseduesin, pyet persona të tjerë për të. Preferohet që gazetari paraprakisht të bëjë një bisedë të lirë me atë që dëshiron ta intervistojë.

“Nëse gazetari dëshiron që të intervistojë një shkrimtar duhet që të lexojë librat e tij. Intervista synon që personalitetet e njohura t’i ofrojë sa më afër publikut”. (Musa Sabedini, ligjërata Zhanret e Gazetarisë, java e shtatë, 2018)

Kur intervistoni pyeteni bashkëbiseduesin “përse është ashtu” dhe jo “a është ashtu”, sepse nëse burimi mendon se nuk dini asgjë atëherë do të tentojë që t’u bllokojë dhe do t’u shmanget pyetjeve të padëshirueshme.

Qëllimi i gazetarit është që ta shtyjë bashkëbiseduesin të sqarojë dhe të rrëfejë dhe jo të mohojë.

Që t’ia arrini qëllimit, të cilin e synoni, duhet të shkoni deri në fund. Reporterët që nuk besojnë se do të arrijnë që të marrin intervistë ose ndonjë informacion nga burimi kurrë.

(Shiko: [Course: Zhanret e Gazetarisë \(ubt-uni.net\)](http://ubt-uni.net))

nuk do të kenë sukses. Pyetni vazhdimisht dhe mos komentoni. Mos i jepni hapësirë bashkëbiseduesit që të përgjigjet shkurt me “po” ose “jo”. Duhet të keni durim dhe bashkëbiseduesit t’i krijoni komoditetin që të rrëfejë.

Në fillim bëni pyetje të përgjithshme, “të lehta”. Kështu i jepni mundësi që të krijojë besim tek ju. Më pas parashtrooni pyetjet “e vështira”. Pra mos shkoni menjëherë të kulminacioni. Gjatë gjithë kohës sa e intervistoni burimin mos lejoni që t’u kaplojnë ndjenjat. Mos harroni: ju nxirrni përgjigjet dhe nuk jeni ai që i zgjidhni problemet.

Para se gazetari të bëjë një intervistë duhet të ketë parasysh këto gjëra:

Të identifikohet dhe t’i tregojë atij që e interviston se ku do të botohet intervista;

T’i tregojë qëllimin e intervistës;

T’ia tregojë kohëzgjatjen;

T’i japë burimit kohë të mjaftueshme që të përgjigjet: T’i shmanget debatit, fyerjeve, grindjeve me atë që e interviston;

Nëse intervista do të botohet në gazetë nuk është profesionale që përgjigjet të nxirren nga konteksti. Pra gazetari duhet që të respektojë kushtet e parashtuara nga ai që intervistohet. Pyetja kryesore në përzgjedhjen e bashkëbiseduesit për intervistë është: pse pikërisht ai pyetet për ndonjë temë? Çfarë dobie do të ketë publiku nga kjo intervistë? Cili është qëllimi i intervistës? Menjëherë duhet të thuhet se çfarë ndërlidhje përmbajtësore ka i intervistuari me temën konkrete.

Intervista është shkëmbim i orientuar pyetjesh dhe përgjigjesh përmes të cilave do të merren informacione. Qëllimi është që në kohë sa më të shkurtër të mundur nga personi që intervistohet të merren informacione të qarta dhe mjaftueshëm të zgjeruara. Nga njëra anë intervista është formë e veçantë gazetareske. Nga ana tjetër, informacionet e marra mund të shfrytëzohen si lajme, raporte ose komente.(Musa Sabedini, ligjërata Zhanret e Gazetarisë, java e shtatë 2018)

Për të gjitha intervistat vlen: i pyeturi është personi kryesor. Rrëfimet e tij janë pjesa më e rëndësishme e intervistës. Gazetari që e zhvillon intervistën sillet si ndërmjetësues mes të intervistuarit dhe dëgjuesve, shikuesve ose lexuesve. Pyetjet e tij janë të shkurtra, precize dhe zakonisht të orientuara drejt arritjes së qëllimit të intervistës. Ai duhet të jetë neutral.

dhe të përmbahet nga emocionet e mundshme që do të dilnin nga përgjigjet. Mendimi i tij nuk guxon të vijë në shprehje. Më me rëndësi është që praktikisht të mblidhen fakte, të kryhen hulumtime për temën dhe personin që intervistohet. Me këtë para se të fillojë intervista duhet të jetë e qartë deri ku janë “linjat e kuqe” dhe cili është qëllimi që duhet të arrihet. Gazetari duhet të mendojë se si do të arrijë bisedë interesante dhe të tendosur dhe çfarë konfliktesh mund të shkaktojë. Gazetari duhet të ruajë qëndrim të orientimit drejt thelbit, racionalitetit dhe kritikës. Nëse i intervistuari është ekstensiv, guxon ta ndërpresë, por kjo të jetë në mënyrë të sjellshme, që i intervistuari të detyrohet të flasë qartë. Intervista në formë të shkruar, të shtypur dhe në Internet, transmetohet me pyetjet në formë kursive, ndërsa përgjigjet me shkronja normale dhe veçohet me rresht të zbrazët.

Gjithashtu edhe të dhënat për të intervistuarin të shënohen në kursiv në intervistë. Është një nga llojet më komunikative informative. Me të opinionit i ofrohet informacioni në formë pyetjesh e përgjigjesh, në bazë pyetjesh e përgjigjesh, në kuadër të pyetjeve e të përgjigjeve ose me rastin e pyetjeve e përgjigjeve. Edhe teoricienët këtu sikur janë treguar cikërrimtarë dhe e kanë stërholluar definicionin. Asnjë lloj tjetër i shprehjes në gazetari nuk është më i padefinuar se intervista, sa i përket procesit të sajimit të intervistës, klasifikimit dhe karakteristikave të saja.

(Shiko: [Course: Zhanret e Gazetarise \(ubt-uni.net\)](http://ubt-uni.net))

Disa mendojnë se ka aq lloje intervistash, sa ka gazetarë që merren me të. "Secili që është mjeshtër në gazetari gjatë çdo takimi të ri bën intervistë të re". Disa intervistën e quajnë raport mbi bisedën. Ndonjë tjetër bën dallimin e intervistës: "Pyetje - përgjigje, pyetje - përgjigje" nga intervista që jep edhe atmosferën me përshkrime të herëpashershme...

Ka hyrë në tekstet teorike të zhurnalistikës klasifikimi që ka bërë profesori i kësaj lënde, gazetar i Lublanës Toma Martelanac, duke i kategorizuar intervistat në pesë grupe me nëngrupet:

- sipas përmbajtjes - politike, ekonomike, kulturore, sportive
- sipas vëllimit - individuale dhe në grup
- sipas mënyrës - gojore, të shkruara, telefonike

- sipas rëndësisë - risi, personale, biografike, polemike
sipas ndërtimit - të thjeshtë ose të përzemërt.

Këtij kategorizimi të tjerët më vonë i kanë shtuar edhe dy grupe të tjera:

- sipas përgatitjes - të përgatitura dhe të improvizuara
- sipas dedikimit - informative, edukative ose argëtuese.

Sipas medimeve ka intervistë gazete, radioje dhe televizionit.

Sipas mënyrës së hartimit dallohen:

- intervista klasike
- intervista e kombinuar
- intervista e improvizuar.

Intervistë klasike merret intervista e përgatitur. Për këtë lloj interviste pyetjet përgatiten që më parë. Shkruhen dhe i jepen bashkëbiseduesit, i cili gazetarit ose i përgjigjet me shkrim ose drejtpërdrejt. Kur ky komunikim bëhet me shkrim, "bashkëbiseduesit" ndodh që të mos shihen fare. Këtë formë interviste më së shumti e aplikojnë gazetatat. Por, intervista klasike mund të përgatitet edhe për radio. Ai incizohet në studio dhe nuk ndryshohet. Mungesa e tij është se nuk bëhet në kushte të natyrshme dhe duket artificial. Kjo ndodh sidomos nëse hetohet leximi. Prandaj shpesh bashkëbiseduesit i jepen më parë pyetjet dhe ai i stërvit përgjigjet përmendësh. Gazetari pastaj e "pastron" tekstin e folur nga belbëzimet eventuale. Dhe kështu kombinohet.

Për llojin e intervistës së improvizuar përgatitet vetëm gazetari. Të intervistuarit vetëm i njoftohet tema. Intervista e improvizuar mund të jetë e drejtpërdrejtë (gazetari pyet, i intervistuari përgjigjet aty për aty, ose edhe të incizohet e pastaj të montohet në studio, kur ka mundësi të bëhen shkurtime.

(Shiko: [Course: Zhanret e Gazetarise \(ubt-uni.net\)](http://ubt-uni.net))

Në intervistat që bëhen drejtpërdrejt gazetari duhet të jetë veçanërisht i shkathët, që pyetjet t'i bëjë sa më qartë e më shkurt, në moment të qëlluar dhe me kërkesë të qëlluar.

Në asnjë rast të demonstrojë nivelin e "lartë" të njohurive, të superioritetit, të flasë më gjatë se mysafiri. Lexuesi e dëgjuesi duan të dinë ç'mendon e ç'thotë i zgjedhuri për bisedë, jo gazetari. Por, gazetari duhet të ketë aftësi që bisedën ta mbajë në kontroll, do

të thotë brenda kornizave të temës, ta orientojë nëse bashkëbiseduesi "harron".

Gazetarët, në bazë të përvojës së fituar, kanë dalluar tre tipa bashkëbiseduesish, varësisht nga ajo sesa flasin:

- që flasin shumë - biseda me ta zhvillohet qetë, me durim;
- që nuk flasin shumë - biseda me ta bëhet me durim por aktivisht, duke e nxitur;
- s' flasin gjë! - me të tillë s'ka rregullë. Ka mundësi të shfrytëzohet edhe heshtja e tyre, por me shkathtësi. Edhe intervistës i duhet shkasi: një lajm, një fakt, një moment aktual politik, ekonomik, kulturor, shkencor, letrar, social, për të cilën personaliteti që zgjedhjet për intervistë din më shumë dhe shquhet për nga kompetenca. Për intervistë të suksesshme është e domosdoshme tema, personaliteti me të cilin bëhet intervista, dhe pyetjet, mjeshtëria, zgjedhja e pyetjeve. Ose edhe më hollësisht janë të domosdoshme: zgjedhja e pyetjeve të qëlluara, tema e qëlluar, koha e qëlluar, personi i qëlluar.

Këtu ka rëndësi që informacionet dhe vlerësimet që bëhen me anë të intervistës nuk i jep as gazetari, as redaksia, por personi i njohur, kompetent, autoritativ, njohësi i çështjes, të cilit i beson opinioni. Fjala e drejtpërdrejtë gjithsesi është më efektive se ajo e tërthortë, me ndërmjetës, e transmetuar përmes tjetrit dhe prandaj edhe si formë e shprehjes, po edhe si mënyrë e komunikimit është shumë e popullarizuar.

Megjithatë, nderi i mbetet gazetarit që ka ditur të bëjë pyetjet dhe të zgjedhë bashkëbiseduesin. S'mund të jetë çdo temë lëndë për intervistë. Ajo duhet ta intervistojë një rreth të gjerë njerëzish dhe sa më aktuale të jetë tema aq më shumë do të ketë vlerë intervista. Pra vlerën e temës e përcakton të shumtën momenti aktual.

Natyrisht do të shkojë huq mundimi për gjetjen e temës aktuale, nëse nuk ia qëllohet bashkëbiseduesit, i cili duhet të ketë një peshë që e dallon nga të tjerët, në fushën që vepron dhe brenda të cilës i bëhen pyetjet, ndërkaq nëse intervista bëhet për radio ose televizion ai duhet të ketë edhe zërin radiofonik, përkatësisht pamjen për televizion, krahas aftësisë oratorike, elekuencës.

(Shiko: [Course: Zhanret e Gazetarise \(ubt-uni.net\)](http://ubt-uni.net))

Tema më e preferuar dhe personi më i preferuar për intervistim është ekskluziviteti, pralajmi, informacioni a vlerësimi ekskluziv që komunikohet, dhe personi kompetent që mund ta komunikojë atë lajm, informacion a vlerësim ekskluziv.

Faza tjetër e rëndësishme për intervistë të suksesshme është zgjedhja e pyetjeve. Gazetari duhet të di çfarë do. Pyetja e mirë përmban gjysmën e përgjigjes, thotë një rregullë. Nga pyetjet e gazetarit dhe përgjigjet e të intervistuarit varet suksesi i një interviste. Prandaj gazetari duhet të përgatitet para se të bëjë intervistën. Duhet ta njohë materien rreth të cilës do të zhvillojë bisedën. Duhet të di edhe çfarë i intereson opinionit të di nga ai që intervistohet. Pyetjet duhet të jenë të qarta, që nuk prejudikojnë përgjigje, gjuhësisht të formuluar drejt. Do të jetë e dënuar për dështim intervista që do të fillonte, ta zëmë: Ç'mund të na thoni për situatën aktuale politike?

(nëse bisedohet për çështje politike e me ndonjë politikan), Çfarë është situata ekonomike në republikën tonë? (nëse flitet me personin përgjegjës për këtë fushë), Çfarë janë vlerat artistike të veprës letrare, figurative a shkencore (varësisht nga fusha për të cilën intervistohet njeriu përkatës).

Edhe intervista i ka ca rregulla, në bazë të të cilave ndërtohet, komponohet, ani pse as këtu s'ka shabllone, klishe.

Hyrja duhet t'i njohë marrësit (receptientët) me temën dhe me personalitetin e atij që intervistohet. Kjo vlen për të gjitha mediumet. Në radio ose televizion këto elemente mund të jepen me rastin e paralajmërimit të intervistës.

Rrjedha e intervistës përbëhet nga pyetje e përgjigje. Përmes tyre bëhen analiza, jepen shpjegime, dëshmohet, paraqiten argumente dhe kundër argumente.

Si edhe në format e tjera edhe këtu në fund jepet konkluzioni, përfundimi, me të cilin bëhet përgjithësimi, rezimimi, konstatohet diçka dhe nxirret porosia.

Tetë rregullat të cilave duhet t'u përmbahet gazetari kur interviston:

1. Njihe sa më shumë, përpara, atë me të cilin bisedon;
2. Përgatit pyetjet themelore;
3. Afroju me besim;
4. Përdor citate drejtpërdrejt;

5. Bëni pyetje direkte;
6. Mbaj shënime të sigurta;
7. Kij kujdes ndaj përgjigjeve kryesore;

Mbaj mend karakteristikat themelore të personalitetit me të cilin bisedon.

(Shiko: [Course: Zhanret e Gazetarise \(ubt-uni.net\)](#))

Gjërat që duhen marrë me vete në një intervistë

- Kartëvizita
- Botime të organizatës suaj
- Lista e dokumentave që kërkoni nga personat e intervistuar
- Kartelë me fotografi të identitetit
- Ndonjë broshurë të organizatës suaj
- Një përshkrim njëfaqësh të projektit në të cilin jeni duke punuar
- Dokumentet kryesore për referenca
- PyetëSORIN
- Shënime nga intervistat e tjera(për referenca dhe verifikim)
- Një fletore për shënime
- Diktafonin (nëse planifikoni të incizoni)
- Listën e kontakteve
- Dosjen në të cilën ju organizoni dokumentet tuaja
- Telefonin

(Shiko: [Course: Shkathtësite e shkrimit 1 \(ubt-uni.net\)](#))

“Intervista shpesh keqkuptohet ose përdoret gabimisht. Një bisedë e zakonshme prezantimi për një vend pune quhet shpesh intervistë. Nuk është e tillë, pasi përmbajtja e saj mbetet aty, nuk është për publikun. Dhe nuk është intervistë. Intervistë nuk është as anketa me një numër pyetjesh të caktuara . As biseda për një çështje të caktuar”(Safet Zejnullahu, ligjërata Shkathtësitë e Shkrimit1, java e dymbëdhjetë)

Mos e fillo intervistën me pyetje të mëdha, fillo me pyetje të zakonshme dhe më pak të rëndësishme për të shkuar kah pyetjet e “vërteta”.

Mos bëjë komente gjatë pyetjes, bjeri sa më shkurt:

Bëje mik bashkëbiseduesin- lejo që të flas edhe gjëra të parëndësishme;

Përgjigjja e madhe- nëse bashkëbiseduesi ju ka dhënë një përgjigje shumë të mirë, një fakt ekskluziv, ruani qetësinë, mos reagoni sepse do ta shkatërroni gjithë punën.

Vazhdo rrjedhën e intervistës sikur s’ke vërejtur asgjë. Bashkëbiseduesi mund të ketë përgjigje edhe më të rëndësishme. Nëse bashkëbiseduesi dëshiron ta ndërpresë bisedën, respektojeni vendimin e tij, pas rifillimit mund të merrni përgjigje më të mira

Nëse keni një pyetje që e huton bashkëbiseduesin, kërkoni falje për pyetjen e pa takt, mund ta bëni atë pyetje të riformuluar, më vonë gjatë rrjedhës së bisedës. Më e vështira është kur intervista botohet në gazetë, për shkak të kufizimit të mediumit dhe pamundësisë së atyre që i pranojnë, t’i shohin dhe dëgjojnë bashkëbiseduesit...

Parapërgatitjet e mëtutjeshme...

Hulumtojeni temën të cilën e punoni!

Kuptoni diçka më shumë për personin më të cilin do të bisedoni!

Informacione për biografinë!

Hulumtojini librat apo tekste të cilat i kanë shkruar!

Hulumtojeni Web faqen e tij!

Përgatitni pyetjet!

Radhitini pyetjet sipas rëndësisë!

Së pari pyetjet e thjeshta, pastaj ato më të rënda!

Mos e harroni këndin e stories suaj: a përgjigjen përgjigjet me temën tuaj!

Mos humbni kohë gjatë bisedës; mos bëni pyetje, përgjigjet në të cilat mund t’i gjeni diku tjetër.

Fillimi i intervistimit...

- Realizojeni bazën!
- Sa kohë keni?

- Çka është tema e bisedës?
- Cilat burime i keni?
- Vërtetoni emrin dhe titullin e bashkëbiseduesit
- Krijoni raporte të mira: para intervistës bisedoni për gjëra tjera, relaksohuni...
- Tregoni interesim: gjuha e trupit i ndihmon bashkëbiseduesit me qenë më i hapur.
- Në rast të storjes me fytyrë njeriu: provoni të nxitni përgjigje personale, anekdota...

Llojet e pyetjeve

- Pyetjet me përfundim të hapur: përgjithshme, lejoni bashkëbiseduesin të flet.
- Pyetjet me përfundim të mbyllur: pyetje specifike me përgjigje specifike
- “Po” ose “Jo”...
- Pyetjet pasuese: në mënyrë që pyetjet të zgjerohen...
- Pyetjet udhëzuese: (njerëzit janë hidhëruar, apo jo?)
- Pyetjet “Udhëtuese” (Çka mendoni për çmimet e kafes? Për recesionin botëror... Për EULEX-in në Kosovë...?)

Kualitetet ideale të prezantuesit janë:

Autoriteti

Kredibiliteti

Qartësia

Ngrohtësia

Personaliteti

Profesionalizmi

Zëri i mirë

Dukje e mirë tuaj

(Shiko: [Course: Shkathtesite e shkrimit 1 \(ubt-uni.net\)](http://Course:Shkathtesiteeshkrimit1(ubt-uni.net)))

2.2 Avantazhet dhe dizavantazhet e intervistave

Avantazhet

Lejon pjesëmarrësin që të përshkruaj se çfarë është e rëndësishme për të duke përdorur fjalët e tij ose të saj në vend që të kufizohet për kategori të përcaktuar, kështu pjesëmarrësit mund të ndihen më të relaksuar dhe të sinqertë,

Ofron kredibilitet dhe vlefshmëri të lartë;

Lejon intervistuesin të hetojë për më shumë detaje dhe të sigurohet që pjesëmarrësit janë duke interpretuar pyetjet në mënyrën se si ata e mendojnë, Intervistuesit kanë fleksibilitet për të përdorur njohuritë, ekspertizën dhe aftësitë e tyre ndërpersonale për të eksploruar ide interesante apo të papritura ose temat e ngritura nga pjesëmarrësit.

Dizavantazhet

Kostoja është një dizavantazh i madh i intervistave, Duhet njerëz për të kryer intervistat, që do të thotë se ka kosto personeli dhe kostoja e personalitetit është kosto më e lartë e një biznesi. Cilësia e të dhënave nga intervistuesi shpesh do të varet nga aftësia e intervistuesit, Disa njerëz kanë aftësi të natyrshme për të kryer një intervistë dhe për të mbledhur të dhënat mirë, Disa intervistues mund të kenë paragjykimet e tyre dhe që mund të ndikojnë në mënyrën se si përgjigjet i intervistuari.

Përpunimi i të dhënave në mënyrë manuale, nëse intervista është e administruar në letër të dhënat e mbledhura nga intervistat duhet të futen manualisht.

Madhësia e kufizuar e mostrës, Madhësia e mostrës është e kufizuar në madhësinë e stafit gjatë intervistimit.

(Shiko: [Diploma Ime: ESE: Pyetësorët dhe intervistat si mjete të mbledhjes së të dhënave \(diplomaime0.blogspot.com\)](http://diplomaime0.blogspot.com))

2.3. Shtypi periodik në Kosovë 2000-2005

Në qershor të vitit 1999 Kosova është bërë protektorat i OKB-së. Ky mision që në krye të tij kishte të Dërguarin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në vitet e para (1999-2002) kishte të gjitha të drejtat legjislative dhe ekzekutive për udhëheqjen e Kosovës dhe rregullimin e funksionimit të të gjitha fushave, përfshirë edhe atë mediatike.

Misioni tjetër i vendosur në Kosovë që kishte përgjegjësinë për lëmin e sigurisë ishte ai NATO-s dhe partnerëve të saj.

Përveç dy misionëve, në Kosovë filluan të veprojnë edhe organizata të ndryshme ndërkombëtare. Bartja e kompetencave të përgjegjësive të UNMIK-ut për vendimmarrjen në politikë, ekonomi, arsim etj., tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë është bërë gradualisht deri në shpalljen e Pavarësisë më 17 shkurt 2008.

(Shiko: [Course: Historia e Gazetarisë 2 \(ubt-uni.net\)](#))

Çlirimi i Kosovës dhe vendosja e misionëve ndërkombëtare, krijuan rrethana të reja për zhvillimin e mediave dhe gazetarisë. 10 vjet pas mbylljes së dhunshme nga regjimi i Millosheviqit dhe periudhës së mbijetesës së mediave në kushte të pushtimit, në Kosovë nisën punën një numër i madh i mediave të reja dhe të shumëllojshme.

Periudha e parë e funksionimit të mediave në Kosovën e çliruar konsiderohet “periudhë e bumit mediatik”. Rrethanat e reja historike mundësua zhvillimin e të gjitha kategorive të mediave.

Në Kosovë filluan njëkohësisht veprimtarinë: gazeta ditore, radio, stacione televizive, zyra të mediave të huaja në gjuhën shqipe. Në fillimin e vjeshtës 1999 skena mediatike vlerësohej e mbushur me: 6 gazeta të përditshme, revista të ndryshme dhe rreth 40 stacione të radios, por me mangësinë në këtë skenë të televizioneve. Deri në fillim të vitit 2000, rreth 24 projekte televizive prisnin për licenca, apo pajisje për të filluar punën.

(Shiko: [Course: Historia e Gazetarisë 2 \(ubt-uni.net\)](#))

Një vit pas luftës (viti 2000) në Kosovë kishte mbi 100 transmetues, rreth 10 gazeta ditore, disa javore, dhjetëra dy javore dhe publikime tjera mujore.

Në fillimin e vjeshtës 1999 skena mediatike vlerësohej e mbushur me:

6 gazeta të përditshme, revista të ndryshme dhe rreth 40 stacione të radios, por me mangësinë në këtë skenë të televizioneve. Deri në fillim të vitit 2000, rreth 24 projekte televizive prisnin për licenca, apo pajisje për të filluar punën.

Një vit pas luftës (viti 2000) në Kosovë kishte mbi 100 transmetues, rreth 10 gazeta ditore, disa javore, dhjetëra dy javore dhe publikime tjera mujore.

Shumica absolute e këtyre mediave ishin në pronësi private. Ndryshimi i modelit të pronësisë mbi mediat është ndër karakteristikat kryesore që e dallon periudhën nga viti 1999 krahasuar me periudhat e mëhershme. Themelues të mediave ishin profesionistë të fushës së gazetarisë, pronarë të kompanive të ndryshme ekonomike, por edhe institucione ndërkombëtare të cilat vepronin në Kosovë.

Ndryshimet në modelin e pronësisë së mediave janë reflektuar edhe në funksionet dhe rolin e mediave në shoqërinë e pas luftës në Kosovë. Funksionet e mediave të kësaj periudhe lidhen me rolin ndikues të tyre në zhvillimet e përgjithshme të shoqërisë dhe sistemin pluralist që nisi të zhvillohej në Kosovë.

Zhvillimi i shtypit të afërt me partitë politike është karakteristikë tjetër e zhvillimit të mediave në Kosovë, pas vitit 1999. Në Kosovë u krijuan kryesisht gazeta të afërta me partitë politike, edhe pse nuk e deklarorin veten si organe të partive kryesore politike. Në përmbajtjen e tyre ofronin promovimin e aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbanin anën e tyre. Gazetat e tilla kanë qenë kryesisht jetëshkurtra dhe zakonisht nuk kanë mbijetuar në treg më shumë se një vit.

(Shiko: [Course: Historia e Gazetarisë 2 \(ubt-uni.net\)](http://ubt-uni.net))

Gazetat kryesore dhe më jetëgjate ditore:

Gazeta “Koha Ditore”

Gazeta “Zëri”

Gazeta “Kosova”

Gazeta “Bota Sot”

Gazeta “Epoka e Re”

Të tërat mund të kenë tirazh ditor nën 10 mijë ekzemplarë;

Ky numër është i ulët në krahasim me popullsinë në Kosovë rreth 2 milionë banorë;

Gazeta e parë shqipe në Kosovë ishte “Rilindja”(1945) që është botuar deri në 60 mijë ekzemplarë.

Nga viti 2005 deri 2015 janë mbyllur: “Dita”, “Tribuna”, “24 orë”, “Infopress”, “Lajm”, “Pavarësia” etj...

Gazeta e parë e pavarur në Kosovë ishte “Koha Ditore”, që filloi të botohej më 31 mars 1977.

(Shiko: [Course: Media e Shkruar \(ubt-uni.net\)](#))

Ballinat e gazetave të përditshme në Kosovë u monitoruan mes 15 korrikut dhe 15 gushtit 2009. Të gjitha storiet u ndanë në tri kategori. Secila storie që ka pasur ekskluzivitet të vërtetë mbi mediat tjera është kategorizuar si ekskluzive. Në kategorinë storie/intervistë, janë kategorizuar të gjitha intervistat dhe storiet që janë bazuar në ngjarje të ditës, por kanë pasur edhe kontribute shtesë, nga burimet tjera, apo në disa raste të mira edhe karakter analitik. Storiet që kanë qenë raporte të thjeshta nga ngjarjet e ditës janë futur në kategorinë e ngjarjeve të ditës. Këto janë storie që janë bazuar në konferenca shtypi, takime protokollare të politikanëve, apo ngjarje tjera, të shkruara dhe botuara thjesht, pa asnjë burim tjetër të cituar e as ndonjë kontribut tjetër.

(Shiko: [Microsoft word - 2010-03-11 KIPRED report on politicization of media alb 1.doc \(osce.org\)](#))

2.4 Arkivi nga gazeta Koha Ditore



Fig.2. Logoja e gazetës Koha Ditore

Në vitin 1997 filloi botimi i gazetës “Koha Ditore”, si gazetë ndryshe dhe që solli risi në mjedisin mediatik të Kosovës së pushtuar. Si një media alternative, ajo zgjeroi interesimin e madh të lexuesve dhe tirazhi i saj ka shkuar deri në 50 mijë kopje në ditë. Në vitin 1999 zyrat e saj u dogjën nga forcat policore serbe. Në periudhën e pasluftës “Koha Ditore” ka vazhduar të jetë njëra ndër gazetatat kryesore dhe më të qëndrueshme në Kosovë.

Botohet në Prishtinë nga kompania Koha, tash pronë e publicistes kosovare Flaka Surroi. Kryeredaktor i gazetës është Agron Bajrami. Koha Ditore njihet si gazeta më e lexuar dhe më e shitur në Kosovë. Botimi ndërkombëtar i Kohës Ditore mund të blihet në vende të caktuara pothuajse në të gjithë Evropën.

Në 11 vitet e fundit, Koha Ditore ka rezultuar si gazeta më e lexuar dhe më e besuar.

(Shiko: https://en.wikipedia.org/wiki/Koha_Ditore)

Gazeta Koha Ditore(Koha.net) përmban këto rubrika:

Lajme

Arbëri

Metro

Kosovë
Botë
Kronikë
Kronikë e zezë
Kulturë
Sport
MES
Top Koha Music
Showbiz
Lëmsh
Auto
Life Style
Tech
Recetat e Lindes
Vështrime
Horoskopi
KTV Programi
Covid19
Te Linda
Fjalëkryq
Video
Arkivi
Shpallje
Përkujtime

2.5 Arkivi nga gazeta Epoka e re



Fig.3. Logoja e gazetës Epoka e re

U themelua me 15 dhjetor 1999, numri i parë doli me 25 janar 2000.

Kjo gazetë është gazetë e përditshme shqiptare, njihet si gazetë e njerëzve të lirë.

Editor i kësaj gazete është Muhamet Mavraj, personalitet i njohur gjatë demonstratave studentore të 1997'ës. Epoka e Re shquhet për shkëputjen e saj nga shablloni zyrtar i kohës, në të cilin amullojnë të gjitha gazetatat e tjera "të pavarura" në Kosovë. Epoka e Re, shquhet për kuadrin e saj kritik gazetaresk, i cili pikësynon arritjen e një informacioni të ri në mjedisin shqiptar dhe formësimin e audiencës kritike.

Epoka e Re njihet si gazeta më e guximshme shqiptare.

(Shiko: https://en.wikipedia.org/wiki/Epoka_e_Re - Bing)

Gazeta Epoka e re përmban këto rubrika:

Ballina

Lajme

Ekonomi

Intervista

Opinione

Komuna

Fejtone

Botë
Kulturë
Sport
Diaspora
Spektër
Shpallje
Tech

2.6 Arkivi nga gazeta Zëri



Fig.4. Logoja e gazetës Zëri

Zëri është gazetë e përditshme kosovare, që publikohet që nga viti 1999, duke qenë kështu njëra nga gazetatat më të vjetra që publikohet në Kosovë. Zëri cilësohet nga lexuesit si gazetë politikisht e pavarur. Nga muaji shtator i vitit 2009, Zëri është pronë e Lindi Media Group, një konzorciumi medial, kosovaro-gjerman. Tradita e krijuar nga Zëri po shkon drejt modernizimit dhe nga dhjetori i vitit 2009, filloi me dukje moderne, informacion të saktë dhe të fuqishëm.

(Shiko: <https://www.facebook.com/gazeta.zeri> - Bing)

Motoja e re e Zërit është

LEXO ME ZË

Gazeta “Zëri” përmban këto rubrika:

Aktuale

Kronika

Bota

Ekonomia

Showbiz

Sport

Zërat

Auto&Tech

Dossier

Jetë

Arkiva

Kultura

Video

Impresum

Privacy Policy

Shpallje

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Në çdo temë të diplomës padyshim që hasim në disa probleme sa i përket procesit të hulumtimit dhe mënyrës së gjetjes së materialit për titujt, nëntitujt që i shtjellojmë në punim.

Sa i përket temës së diplomës “Intervista e suksesshme në mediat e shkruara në Kosovë dhe aftësia e intervistuesit”, padyshim që nuk ka qenë hulumtimi dhe punimi i temës i lehtë pasi që çdo burim i materialit duhet të jetë sa më i vërtetë.

Materiali i kësaj pune është e gjitha me burime të vërteta, materialit i marrur ceket tek referencat të paraqitur në linke në mënyrë për ata që lexojnë këtë temë diplomë të kenë përballë material real. Në këtë pjesë do të krahasojë gazetat dikur dhe gazetat e ditëve të sotme.

3.1 Mediat e shkruara dikur dhe sot

Dihet që gazetat kanë një jetëgjatësi, me lindjen e gazetarisë lindën edhe gazetat.

Ato njihen për besueshmërinë e lajmeve, ose jetëgjatësia e tyre kaq e madhe i ka bërë të tilla, gazetat e ditëve të sotme dallojnë shumë me ato të mëhershmet, si nga lexueshmëria gjithashtu dallojnë edhe nga dukja. Gazetat e mëhershme ishin pa ngjyra vetëm në të zeza, sot teknologjia ka avancuar me të madhe dhe gazetat duken më mirë me ngjyra, edhe fotografitë duken më bukur. Kur jemi tek teknologjia mund të themi se kjo gjë nuk ka ndikuar mirë tek mediat e shkruara, u krijuan shumë media online, rrjetet sociale dhe kjo bëri që gazetat të mbesin nën hije.

Tirazhi i ultë i mediave të shkruara është fenomen që ka përcjellë gazetat në gjithë botën në dy dekadat e fundit. Ky trend është rritur sidomos me zgjerimin e rrjeteve televizive dhe mediave të internetit, të cilat janë në gjendje të ofrojnë lajme për publikun menjëherë, duke përdorur përveç tekstit edhe platforma audio-vizuale. Gazetat janë lënë në pozitë të pabarabartë në tregun mediatik, si dhe kanë pasur nevojë të bëjnë ndryshime të rëndësishme në politikën redaktuese për të qenë të qëndrueshme.

Gazetat duhet ta përshtatin përmbajtjen e tyre ndaj një publiku të synuar enkas, për të qenë në gjendje konkurrimi edhe me mediat e transmetuara. Gazetat kosovare nuk kanë qenë suksesshme në këtë proces dhe ende vazhdojnë të botojnë lajme të thjeshta të ngjarjeve të ditës, në vend se të fokusohen në raportime më të hollësishme dhe gazetari hulumtuese . Përveç kësaj, gazetatat janë konfuze kur flitet për publikun të cilin e synojnë. Qasja e shumicës së të përditshmeve është elitiste, që do të thotë se synojnë publikun specifik të vendimmarrësve, politikë-bërësve dhe elitës intelektuale.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në tirazhin e gazetave është larmia e kufizuar e përmbajtjes editoriale. Në gazetatat ditore raportohet jashtëzakonisht shumë për çështjet politike, ndërsa raportet e natyrës sociale dhe raportet për industrinë e ndryshme mbulohen në masë minimale. Ajo çfarë konsiderohet të jetë analizë ekonomike, në të vërtetë është raportim i thjeshtë për trendet makroekonomike, kurse raportet financiare dhe afariste janë shumë të rralla, ose gati sa nuk publikohen fare. Ka një mungesë të përgjithshme të analizave të thella, derisa gazetaria hulumtuese mbetet e pazhvilluar.

Ndonëse në parim gazetaria hulumtuese kërkon nga gazetarët që të hulumtojnë më shumë për atë çfarë kanë parë dhe çfarë është thënë dhe të japin informata të reja dhe të panjohura për publikun, në Kosovë gazetaria hulumtuese shpeshherë përzihet dhe ngatërrohet me gazetarinë e informatave që kanë rrjedhur nga diku apo gazetarinë e storieve ekskluzive. Shtojcat për art, kulturë dhe mënyrën e të jetuarit, të cilat botohen në gazeta gjatë fundjavës janë mjaft të popullarizuara dhe lexohen shumë. Megjithatë, raportet e tilla nuk janë të pranishme sa duhet në botimet e fundjavës. Artikujt për mënyrën e të jetuarit janë të mangëta dhe gazetaria për të popullarizuarit, e cila zakonisht tërheq vëmendjen e të rinjve, janë në fazën e parë të zhvillimit. Veç kësaj, gazetatat shumë rrallë publikojnë vështrime të kulturës dhe artit, derisa seksione që flasin për ushqim dhe pije nuk ka. Një përmbajtje e larmishme e gazetës do të mund të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në shitjen dhe tirazhin e saj. Pasurimi i përmbajtjes dhe përqendrimi në agjendën e tyre të lajmeve do të shtonte drejtpërdrejt tirazhin e gazetave. Krijimi dhe mirëmbajtja e agjendës së tyre të lajmeve është detyrim për të gjitha mediat, e veçanërisht për gazetatat.

(Shiko:[Microsoft word - 2010-03-11 KIPRED report on politicization of media alb 1.doc \(osce.org\)](#))

“Që të mbijetojnë më gjatë, gazetat duhet t’i konkurrojnë mediat e tjera elektronike.”(Ferid Selimi, ligjërata Media e Shkruar, java e gjashtë)

Mediat e bazuara në internet në Kosovë do të jenë konkurrentët e radhës në tregun e lajmeve. Ndonëse aktualisht ka mjaft portale në funksion, ende pritet që të ndodh ekspansioni i mediave elektronike në Kosovë. Këto publikime të reja, jo vetëm që do të kenë përparësinë e kohës dhe teknologjisë, por gjithashtu të audiencës në rritje dhe çmimit më të ultë. Prandaj, në të ardhmen e afërt, këto paraqesin kërcënim për të gjitha mediat, veçanërisht për gazetat.

Sikur nuk mjaftonte kjo, kohëve të fundit gjithë botën në përgjithësi e kaploi një pandemi globale, virusi Covid19 një armik i njeriut që nuk shihet. Duke shkaktuar rënie ekonomike në çdo sferë të jetës.

Si duket gazetave kjo pandemi u ka dhënë goditjen finale, shumë redaksi u mbyllën dhe nuk funksionojnë më.

Rreth 98 % e mediave në Kosovë kanë deklaruar se pandemia COVID-19 kanë ndikuar në funksionimin e tyre si biznes, kurse rreth 3 për qind prej tyre thonë se koronavirusi nuk ka ndikuar deri tani në funksionimin e tyre. Por 63 për qind e kompanive mediale thonë se rrezikojnë të mbyllën nëse vazhdon tutje pandemia.

Këto shifra u bënë të ditura nga hulumtimi “Efekti i pandemisë Covid-19 në mediet e Kosovës”

Situata e krijuar nga Covid-19 u ka pamundësuar katër të përditshmeve kosovare që të botohen. Aktualisht ato po funksionojnë online. Udhëheqësit e këtyre gazetave thonë se janë dëmtuar financiarisht për shkak të ndërprerjes së kontratave të marketingut që i kanë pasur me bizneset. Disa nga ato kanë pushuar një pjesë të punëtorëve nga puna, ndërsa disa ua kanë ulur pagat. Nëse zgjatë kjo situatë e pandemisë, rikthimi i tyre do të jetë sfidues dhe ndoshta për ndonjërin i pamundur.

Viteve të fundit gazetat ditore janë përballur me vështirësi për të funksionuar për shkak të shtimit të mediave online. Për këtë arsye disa nga ato kanë ndërprerë botimin në formë të shkruar, duke kaluar në versionin online.

(Shiko: [Pasojat e pandemisë edhe te mediat, kërkohet mbështetje nga Qeveria - Telegrafi](#))

Por, përveç kësaj, gazetat janë goditur shumë nga pandemia Covid-19. Që nga 16 marsi i këtij viti ato nuk janë duke u botuar. Kjo ka shkaktuar dëme financiare te këto gazeta për shkak se bizneset i kanë ndërprerë kontratat e reklamimit. Në anën tjetër të hyrat u kanë mbetur minimale edhe nga reklamat në portale.

Aktualisht në tregun medial të Kosovës janë tri gazeta: Koha Ditore, Bota Sot dhe Epoka e Re. E përditshmja tjetër “Zëri” nuk ka mundur të përballojë shpenzimet prej kur është ndalur së botuari. Për shkak të vështirësive financiare, ky medium ka larguar një pjesë të stafit nga puna, dhe tani funksionon vetëm si portal.

Ndërkaq, gazeta “Bota Sot” ka vendosur që të ulë pagat e punëtorëve, e jo t’i largojë ata nga puna.

“Marrë parasysh se edhe numerikisht numri i mediave online në Kosovë është shumë më i madh se sa i mediave të printuara ankesa më shumë vijnë në për mediat online. Por, mediat kryesore të shkruara për vite në Kosovë kanë shërbyer si shkolla më vete të gazetarisë, andaj shkeljet etike janë më të pakta, Kjo për shkak se ende në disa nga këto media ekziston një filter më i rreptë i shkrimit dhe publikimit të lajmit”(Imer Mushkolaj)

(Shiko: [Pasojat e pandemisë në mediat e shkruara - KosovaLive360](#))

“Ngjarjet politike as që mund të perceptohen dhe kuptohen pa ndërmjetësimin e masmediave.

